

I. BAZA LIGJORE E PROJEKTBUXHETIT OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN .

Projekt buxheti propozohet në mbështetje ligjit nr.147/2015 dhe ka për qëllim krijimin e mekanizmave të bashkëpunimit mes shoqërisë dhe institucionit. Ai rregullon krijimin, organizimin dhe funksionimin e Njesise Vendore, si një strukturë e pavarur, konsolidimit të qeverisjes së mirë të saj, rritjes së transparencës në vendimmarrjen publike nëpërmjet përfshirjes më të mirë të shoqërisë në këtë proces.


Ky projekt buxhet është rezultati i zbatimit të reformës administrativo-territoriale (RAT), përcaktuar në programin e qeverisë të miratuar në Kuvend në shtator 2013. Hartimi dhe zbatimi i tij u krye në përmbushje të kërkesave ligjore të përcaktuara në:

- Ligjin nr. 139/2015 “Për Vetqeverisjen Vendore”
- Ligjit nr.9936 datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”
- VKM nr. 1619 datë 02.07.2008 “Për klasifikimin e funksioneve ,grupimin e njësive të qeverisjes vendore për efekt page dhe caktimin e kufijeve të pagave të punonjësve të organeve të qeverisjes vendore” , i ndryshuar me vkm nr.568 datë 17.07.20013 dhe vkm nr. 689 datë 29.07.2015
- Ligjit nr.10399 datë 17.03.2011 për disa ndryshime të ligjit nr.9355 datë 10.03.2005 “ Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”
- Të tjera akte ligjore dhe nënligjore të nxjerra në zbatim të tyre.


Ky projekt buxhet përfshin tabelat e detajuara për çdo aktivitet, duke marrë parasysh që njësia jonë vendore do të mbulojë me shërbime një sipërfaqe prej 477 km², me një popullsi 43.528 banorë, me një sipërfaqe toke buqësore 10.121 ha. Gjithashtu në këtë projekt buxhet janë marrë parasysh dhe funksionet të cilat ju transferuan njësive vendore sic janë mirmbajtje rrugë rurale, mbrojtja nga zjarri dhe shpëtimi, arsimiti parashkollor dhe parauniversitar , ujitja dhe kullimi, dhe shërbimi pyjor.

II. PROJEKTBUXHETI DHE KOMPONENTET E TIJ

Në total projekt buxheti i vitit 2016 arrin në vlerën 350.302.337 lekë. Krahasuar me vitin 2015 në momentin e bashkimit të ish komunave me institucionin e bashkisë ka një rritje prej 117.432.139 lekë më tepër . Kjo për shkak të ndryshimit të formules për llogaritjen e transfertës së pakushtëzuar dhe rritjes së, gjithashtu këtë vit për shkak të ndryshimit të taksave dhe tarifave vendore do të kemi dhe rritje të planifikimit të të ardhurave në shumën 13.027.970 lekë (kjo e trajtuar nga sektori i tatim-taksave në relacionin përkatës). Dhe një pjesë tjetër në rritje janë të ardhurat e trashëguara nga viti i kaluar në vlerën 9.946.503 lekë. Paraqitja e diagramit të mëposhtëm tregon qartë rritjet e buxhetit të vitit 2016, krahasuar me atë të vitit të kaluar.



- ✓ Formula e re e ndarjes së transfertës së pakushtëzuar identifikon nevojat për shpenzime të njëjësive vendore duke u bazuar tek popullsia relative, dendësia e popullsisë për çdo njësi dhe tek numri faktik i nxënësve në shkollat 9-vjeçare dhe të mesme në çdo bashki. Përveç komponentit të dendësisë, formula e re e ndarjes së transfertës së pakushtëzuar sjell edhe ekualizimin e kapacitetit fiskal (të matur nga të ardhurat faktike nga taksat e ndara ndërmjet qeverisë qendrore dhe asaj vendore), të cilat mblidhen dhe u transferohen plotësisht ose pjesërisht bashkive nga administrata tatimore qendrore. Ekualizimi fiskal bazohet në të ardhurat faktike nga tatim fitimi i thjeshtuar i biznesit të vogël, nga taksa vjetore e automjeteve të përdorura dhe taksa e kalimit të pasurisë për pasuritë e paluajtshme të shitura nga personat juridikë. Për vitin 2016 kjo transfertë për bashkinë Devoll është parashikuar të jetë në vlerën 139.872.617 lekë. Për shkak se institucionit tonë i kaluan edhe funksionet e tjera, këto funksione janë mbështetur edhe me fondet e tyre përkatëse si transfertat të kushtëzuara, keto janë në vlerën 67.821.887 lekë të ndara sipas funksioneve. Në total të buxhetit ky ze 49.5 %.
- ✓ Të ardhurat nga tatimet dhe taksat vendore parashikohen të jenë 77.500.000 lekë dhe zenë 27 % në total të buxhetit. Rritja dhe analiza e tyre është trajtuar nga sektori i tatim taksave.
- ✓ Të ardhurat e papërdoruar që trashëgohen nga viti i kaluar janë 65.108.054 lekë të cilat zenë 23.5% të buxhetit
- ✓ Transferta specifike për këto vit është parashikuar në Shumen 67.821.666 leke transferte e cila është e destinuar për paga dhe shërbime për punonjësit e transferuar të cilët janë në total 83 persona.



III. STRUKTURA

Në kuadër të reformës territoriale nga ana e agjensisë së reformës territoriale na është sygjëruar struktura për bashkinë e nivelit tonë. Në total struktura e bashkisë Devoll planifikohet të jetë 233 punonjës, pagat e të cilëve do të përballohen nga ky buxhet. Në këtë strukturë përfshihen edhe funksionet që na transferohen në duke plotësuar struktura të plota për funksionimin e secilit sektor, sic janë kullimi dhe ujitja, pyje dhe kullota, apo emergjencat civile. Në këto struktura në transferuam punonjës nga institucionet përkatëse, por jo struktura të plotë për çdo sektor. Kjo diferencë e pa transferuar është planifikuar nga ana jonë për mirfunksionimin dhe mbarëvajtjen e punës. Në total të buxhetit rreth 32.2% kalon për paga, sigurime shoqërore, fondi i vecantë dhe pjesa për rreth 3.000.000 lekë që do të përdoret për lirimet e punonjësve nga detyra dhe shpërblimin e tyre në bazë të ligjit për nënpunësin civil apo kontratave të punësimit. Shuma e planifikuar për pagat e 150 punonjësve nga transfertat e pakushtëzuar, të ardhurat dhe të trashëguarat është 97.171.000 lekë. Ndërsa nga transfertat specifike për pagat e 83 punonjësve

eshte 55.664.819 leke. Sic shihet pjesën më të madhe të fondit të pagave e zë administrata pasi në të përfshihen drejtoritë dhe sektorët e hartimit të politikave, agjensia e inspektimit të territorit, dhe qendrat e shërbimeve me një ndalesë (one stop shop). Me poshtë jepen në mënyrë analitike sipas zerave perkates:

Nr.	Ermertimi	Programi	Vlera
1	Paga ne administrate	1110	54,868,000
	Sigurime shoqerore ne administrate		8,250,000
2	Paga ne kulture	8250	2,372,000
	Sigurime shoqerore ne kulture		378,000
3	Paga ne Cerdhe	10140	2,268,000
	Sigurime shoqerore ne Cerdhe		361,000
4	Paga ne Sherbime publike	6260	13,868,000
	Sigurime shoqerore ne Sherbime publike		2,218,000
5	Paga ne Kullimi	4240	3,650,000
	Sigurime shoqerore ne Kullimi		581,000
6	Paga ne Sherbimi pyjor	4260	3,419,000
	Sigurime shoqerore ne Sherbimi pyjor		544,000
7	Paga ne Arsimi Baze	9120	185,000
	Sigurime shoqerore ne Arsimi Baze		31,000
8	Paga ne Sporti	8140	1,483,000
	Sigurime shoqerore ne Sporti		236,000
9	Paga ne Kanalizime	6330	1,650,000
	Sigurime shoqerore ne Kanalizime		263,000
10	Paga ne Mirmbajtje Rruge	4530	471,000
	Sigurime shoqerore ne Mirmbajtje Rruge		75,000
	Shuma		97,171,000
TRANSFERTA SPECIFIKE			
11	Paga ne Arsimi Baze	9120	40,513,000
	Sigurime shoqerore ne Arsimi Baze		6,766,000
12	Paga Arsimi i mesem	9230	1,591,000
	Sigurime shoqerore Arsimi i mesem		266,000
13	Paga per Pyjet	4260	1,396,953
	Sigurime shoqerore per pnj. E Pyjeve		233,301
14	Paga per Ujitje -Kullim	4240	1,583,815
	Sigurime shoqerore per Ujitje -Kullim		264,500
15	Paga per PMNZSH		2,598,250
	Sigurime shoqerore per PMNZSH		452,000
	Shuma		55,664,819
	Totali		152,835,819

IV. SHPENZIMET OPERATIVE DHE INVESTIMET NE ADMINISTRATE

Duke parë një periudhë të kaluar 5 mujore nga moment i bashkimit të institucionit të bashkisë me njësitë administrative (ish komunat), nga ana jonë janë parë e nevojshme planifikimi i shërbimeve dhe materialeve si më poshtë. Kjo duke marrë parasysh edhe njësitë administrative për bazën materiale dhe shërbimet. Këtë vit ndryshe nga vitet e kaluara është planifikuar një fond prej 1.000.000 lekë për financimin e një programi për mbajtjen e llogarive dhe kontabilitetit e cila i bashkëngjitet dhe një program për zyrën e tatim taksave që do të lehtësojë dhe përmirësojë mbajtjen e të dhënave, si dhe hartimin e raporteve në kohë.

Analiza	MALLRA DHE SHËRBIME	Detyrime 2015	Plan 2016
6020	Materiale zyre dhe të përgjithshme	0	3.330.000
6020100	Kancelari	0	500.000
6020300	Tonera	0	2.430.000
6020500	Dokumenta	0	400.000
6022	Shërbime nga të tretë	434.300	2.714.817
6022001	Energji	260.000	969.817
6022002	Ujë	0	200.000
6022003	Telefon	0	200.000
6022003	Internet	0	459.000
6022004	Posta dhe abonime	0	186.000
6022099	Formatime & instalime	0	200.000
6022011	Kosto trajnimi (ASPA)	0	200.000
6022099	Shpenzime për procedura rregjistrimi të godinave dhe trojeve.	0	100.000
6022099	Shpenzime për harta , për proces regjistrimi	174.300	200.000
6021	Materiale të tjera	0	1.310.000
6021099	Uniforma policie	0	160.000
6021099	Programe PC	0	1.000.000
6021099	Kasaforta	0	150.000
6023	Shpenzime transporti	0	1.956.000

6023100	Karburant për vitin 2016	0	1.326.000
6023200	Pjesë këmbimi	0	400.000
6023200	Siguracione dhe kolaudim makine	0	230.000
6024	Shpenzime udhëtimi	0	650.000
6024100	Shpenzime, dieta	0	650.000
6027	Shpenzime për detyrime dhe kompesime legale	0	1.149.245
6027400	Vendime gjyqësore	0	1.149.245
6028	Shpenzime për kuota që rrjedhin nga detyrimet	856.000	1.761.000
6028100	KRMË (2013+2014)	776.000	1.601.000
6028100	Shoqates se Bashkive	80.000	160.000
6029	Shpenzime të tjera operative	0	6.207.000
6029006	Shpërblimi i këshilltarëve 12 mbledhje	0	2.331.000
6029600	Kryepaq	0	3.776.000
6029099	Shpenzime për konkurime në administratë	0	100.000
	SHUMA TOTALE E SHPENZIMEVE ADMINISTRATIVE	<u>1.290.300</u>	<u>19.078.062</u>
	INVESTIME		
2312101	Rikonstruksion i nënprefekturës Devoll	0	12.000.000
2312100	Projekte	0	18.000.000
2315120	Blerje automjet	0	3.000.000
2315120	Blerje automjet për administratën	0	1.000.000
2312101	Detyrime NJA Hosisht	646.005	646.005
	SHUMA TOTALE E INVESTIMEVE	<u>646.005</u>	<u>34.646.005</u>

V. SHPENZIME OPERATIVE DHE INVESTIME PER KULTUREN

Aktivitetet në zërin e kulturës, janë marrë në konsiderate ato aktivitete të cilat kanë gjetur zbatim gjatë viteve të mëparshme.

Periudha e Realizimit	AKTIVITETE KULTURORE	Detyrime 2015	Plan 2016
	Shuma e aktiviteteve kulturore	0	720.000
Mars	Dita e mësuesit dhe nënës	0	200.000
Prill	Dita ndërkombëtare e Romëve	0	60.000
Prill	Spartakiada e shkollave të rrethit	0	100.000
Maj	Festivali Folklorik ,tipologjik,kombëtar i sazeve Korçë	0	50.000
Qershor	Festa e fëmijëve	0	30.000
Korrik	Festë për mbrëmjen e maturës	0	200.000
Dhjetor	Dita e personave me aftësi të kufizuar	0	30.000
	Olimpiada në lëndët matematike,fizike,kimi,biologji,gjuhë,letërsi	0	50.000
	Materiale festive dhe informuese	216.000	1.800.000
6021099	Projekt “Antologjia poetike e Devollit”	0	200.000
6021099	Dhurata për nxënësit e dalluar	0	200.000
6021099	Dhurata për nxënësit jetim	0	50.000
6021099	Dhurata për nxënësit Romë	0	50.000
6021099	Kartolina urimi për vitin e rri	0	20.000
6021099	Fishekzjarë për natën e vitit të rri	0	70.000
6021099	Skenë e montueshme për aktivitete kulturore	0	320.000
6022099	Gazeta e publikime	0	180.000
6021007	Libra të rinj për bibliotekën	0	96.000
6021099	Shpenzime të tjera	0	52.000

6022001	Energji elektrike	216.000	562.000
	SHUMA TOTALE E SHPENZIMEVE ADMINISTRATIVE	<u>216.000</u>	<u>2.520.000</u>

VI. SHPENZIME OPERATIVE PER SPORTIN

Bazuar në VKB nr.41 datë 30.11.2015 për “Krijimin dhe funksionimin e klubit sportiv Devolli” i konfirmuar nga ana e institucionit të Prefektit , me të cilën jemi regjistruar pranë Federatës Shqiptare të Futbollit. Mbi këtë bazë ne kemi bërë dhe planifikimin për aktivitetet e sportit. Zëri i parë i shpenzimeve janë pagat e lojtarëve që do të paguhen përgjatë një kampionati që përfshin 8 muaj. Gjithashtu janë planifikuar në total 13 ndeshje për të cilat 6 ndeshje zhvillohen në qytetin e Elbasanit dhe 7 të tjera varet nga kategoria në të cilën do të ndodhemi. Për këto është marrë një përafërsi në përlllogaritje. Më poshtë jepet tabela analitike e cdo zëri për shpenzimet e sportit.

ANALIZA	MALLRA DHE SHËRBIME	Detyrime 2015	Plan 2016
	Shpenzime udhëtimi	0	4.950.000
6029099	Paga për lojtarët	0	3.000.000
6024100	Shpenzime udhëtimi	0	1.615.000
6024100	Shpenzime transporti për 120 ditë stërvitje në Progër	0	168.000
6022099	Pagesë për mjekun e ekipit për 13 ndeshje dhe 4 miqësore	0	17.000
6028100	Kuotë për pjesëmarrje në kampionat	0	150.000
	Materiale dhe Uniforma	0	849.000
6021001	Uniforma dhe materiale sporti	0	718.000
6021099	Pleh dhe medikamente	0	21.000
6021099	Rip motori	0	9.000
6021099	Bojë për vijëzime	0	44.000
6021003	Medikamente	0	12.000
6023100	Karburant për makinën korse	0	45.000
	Shërbime për te trete	60.000	321.000
6022001	Energji	60.000	221.000

6022002	Ujë	0	100.000
	SHUMA TOTALE E SHPENZIMEVE SPORTIVE	<u>60.000</u>	<u>6.120.000</u>

VII. SHPENZIME OPERATIVE DHE INVESTIMET PER CERDHEN.

Planifikimi i shpenzimeve për çerdhen është bërë për të mbuluar ushqimin që konsumohet gjatë gjithë vitit për mesatarisht 14 fëmijë në muaj nga 16 fëmijë të regjistruar gjatë vitit 2015. Gjithashtu është planifikuar një fond për kompletimin e dhomes së re, e cila u rikonstruktua në vitin 2015. Më poshtë jepet tabela analitike e çdo zëri për shpenzimet e çerdhes.

ANALIZA	MALLRA DHE SHËRBIME	Detyrime 2015	Plan 2016
6021004	Ushqime	0	480.000
6022001/2/3	Energji + Ujë + Telefon	44.000	340.000
6021099	Gaz për gatim	0	30.000
6021099	Materiale riparimi	0	50.000
6021099	Materiale për kompletimin e dhomës së re.	0	228.800
	SHUMA TOTALE E SHPENZIMEVE PER CERDHEN	<u>44.000</u>	<u>1.128.000</u>
2312104	Rikonstrukcion tualetet e Cerdhes	0	600.000
	SHUMA TOTALE E INVESTIMEVE PER CERDHEN	<u>0</u>	<u>600.000</u>

VIII. SHPENZIME OPERATIVE DHE INVESTIME NE ARSIM

Në këtë program shpenzimet mbulojnë disa nga institucionet arsimore, si: kopshti, shkolla fillore, shkolla 9-vjeçare, dhe shkolla e mesme. Në artikullin “Blerje dru” parashikohet një shumë fondi për blerjen me procedurë të hapur në shumën **6.266.000** lekë për përballimin e periudhës së dimrit me ngrohje për të gjithë shkollat që mbuon Bashkia Devoll. Kjo shumë është përlllogaritur për blerjen e **1.770 mst** dru. Po kështu është planifikuar dhe fondi prej **1.500.000** lekë për lyerjen e të gjitha shkollave dhe kopshteve si dhe institucionet në varesi të saj. Këtë vit është menduar për planifikimin e një fondi prej **600.000** lekë për dritare dhe dyer duke parë gjendjen e shkollave. Gjithashtu dhe blerjen e **200** karigeve për kopshtin pasi në disa raste ata përdorin karrige të mëdha në vend të karrigeve për moshën e tyre. Një fond tjetër është parashikuar për kancelari dhe tonera për shkollat duke parë se ata janë të paisur me kompjutera dhe vazhdimisht kanë bërë kërkesë për tonera dhe kancelari. Në këtë buxhet planifikohet edhe

shuma prej **3.991.012** lekë për kontratën e lidhur ne fundin e vitit për punime që po vazhdojnë të kryhen në të gjitha shkollat e në varësi të bashkisë. Me konkretisht dhe në mënyre me analitike i shohim në tabelën mëposhtë.

ANALIZA	MALLRA DHE SHËRBIME	Detyrime 2015	Plan 2016
6022001	Energji	684.000	2.227.000
6022002/3	Uje +Telefon	0	300.000
6020200	Dru zjari	0	6.266.000
6020200	Materiale pastrimi	0	200.000
6025300	Lyerjet e shkollave	0	1.500.000
6021099	Xhama	0	200.000
6021099	Soba ngrohje	0	960.000
6021099	Fikse zjari (10 cope)	0	66.000
6020300	Tonera (16 cope)	0	160.000
6020100	Kancelari	0	200.000
6021099	Materiale te tjera	0	100.000
6022099	Sherbime te tjera	0	300.000
	SHUMA TOTALE E SHPENZIMEVE NE ARSIM	<u>684.000</u>	<u>12.479.000</u>
2312103	Dyer & Dritare	0	600.000
2312103	Karrige (200 cope)	0	360.000
2312103	Ndertim tualete ne koshtin Proger	0	600.000
2312103	Kolaudim obj. “ Rikon.tualete shkolla M Sala”	2.040	2.040
2312103	Mbikqyrje obj. “Mirmbajtje te shkollate te Bashkise Devoll”	91.200	91.200
2312103	Punime mirmbajtje te shkollave te Bashkise Devoll	3.899.812	3.899.812
	SHUMA TOTALE E INVESTIMEVE NE ARSIM	<u>3.993.052</u>	<u>5.553.052</u>

IX. SHPENZIME OPERATIVE DHE INVESTIME NE KUZ & KUB

Në këtë zë përfshihen shpenzimet për rrjetet ujore të bardha dhe të zeza . Duke parë problematiken e shumtë në këtë zë, nga ana jonë janë marrë parasysh shpenzimet me emergjente për zgjidhjen e një pjese të madhe të problemeve. Eshtë planifikuar një sasi klori ku është parashikuar kryerja e klorinimit tre here ne jave për 33 depo ujesjellesi. Ketu përjashtohet qyteti dhe fshati Bitinckë pasi këto procedura kryhen nga ndërmarja ujësjellës sha. Eshtë parashikuar një fond prej 1.650.000 lekë për rrethimin e 33 depove për rritjen e sigurisë së ujit të pijshëm. Gjithashtu është planifikuar një fond prej 600.000 lekë për të pajisur cdo sahat matës me vula sigurie me rreth 12.000 copë. Gjithashtu edhe një fond i konsiderueshëm për shërbimin e rruajtjes së depove, shkollave ,njësive administrative dhe institucionin e bashkisë është planifikuar në këtë zë . Duke kryer një shërbim të mirë do të kemi dhe një vjelje më të mirë të të ardhurave nga ujësjellsat, të cilët në këtë moment kanë një përqindje të madhe në humbje .Pjesa tjetër e planifikuar është parashikuar për zgjidhjen e disa problematikave në lidhje me kanalizimet e ujërave të zeza dhe shërbimet e mirmbajtjes së pompave të depove etj. Në planin e investimeve është planifikuar fondi prej 7.000.000 lekë për blerjen dhe paisjen e familjeve pa sahatë uji. Nga kërkesat që kanë paraqitur njësitë administrative është planifikuar të blihen rreth 2.000 sahatë uji. Më konkretisht i shohim në tabelën mëposhtme.

ANALIZA	MALLRA DHE SHËRBIME	Detyrime 2015	Plan 2016
6022001	Energji	796.000	2.735.000
6025400	Klor i lëngshëm (Hipoklorik Natriumi)	0	750.000
6025400	Rethime depo ujësjellësi	0	1.650.000
6025400	Vula sigurie	0	600.000
6025400	Shërbim i rruajtjes së depove	0	11.664.000
6021099	Materiale hidraulike	0	2.000.000
6021099	Mirmbajtje KUZ & KUB	0	400.000
	SHUMA E SHPENZIMEVE NE KUZ & KUB	<u>796.000</u>	<u>19.799.000</u>
2313300	Garanci difekti obj. “ Ujësjellësi i fshatit Sul”	372.634	372.634
2314320	Blerje Sahatë uji	0	7.000.000
2313400	Sistemim KUZ	0	200.000
	SHUMA E INVESTIMEVE NE KUZ & KUB	<u>372.634</u>	<u>7.572.634</u>

X. SHPENZIME OPERATIVE DHE INVESTIME NE MIRMBAJTJE RRUGE

Artikulli që zë një shumë të konsiderueshme në këtë zë janë materialet elektrike. Ne trashëguam nga ish komunat një gjëndje kaotike lidhur me ndricimin rrugor. Kishtë mungesa të mëdha në llamba për shtylla që ekzistonin , si dhe lagje pa linja energjie. Në këtë zë janë parashikuar të blihen llamba 75 Ë, llamba ekonomike për shkolla, portollamba,tel për linja të reja, dhe pjesë të tjera për kompletimin e ndricuesave. Një kërkesë dhe nevojë tjetër nga njësitë administrative është paraqitur dhe hapja e rrugëve nëpër arra. Për këtë është parashikuar një sasi cakulli për sistemimin e tyre me mjetet e institucionit tonë. Meqënëse problematikat kanë qënë për një gamë të gjërë shërbimesh është marrë parasysh blerja e një kamioni 10 ton në vlerën 3.500.000 lekë. Në ndricimi rrugor kemi gjithësej 41 kontrata, dhe për energji elektrike është parashikuar shlyerja e faturave nga muaji Gusht 2015 si detyrime dhe faturimet e vitit 2016. Jemi debitore ndaj këtij institucioni pasi pranë nesh nuk paraqitet asnjë fature për detyrimin cdo muaj. Tabela e mëposhtme pasqyron cdo artikull të këtij zëri.

ANALIZA	MALLRA DHE SHËRBIME	Detyrime 2015	Plan 2016
6022001	Energji Elektrike	4.005.000	13.689.000
6020200	Materiale elektrike	837.000	7.837.000
6021099	Riparime trotuari (tek shkolla 9-vjecare)	0	360.000
6021099	Materiale mirmbajte per rruge (cakull)	0	1.380.000
6022001	Lidhjet të reja energjie	0	132.000
6021099	Ruspë për makinën ushtarake	0	500.000
	SHUMA E SHPENZIMEVE NE MIRMBAJTJE RRUGE	<u>4.842.000</u>	<u>23.898.000</u>
2313100	Garanci diffekti obj. “Rruga e varezave fshati Sul”	233.184	233.184
2313100	Garanci diffekti obj. “Rruga Mehmet Mullaj”	77.709	77.709
2313100	Detyrime NJA Hocisht “Sis. i rrugëve buqësore”	186.600	186.600
2315120	Blerje kamion 10 ton	0	3.500.000
	SHUMA E INVESTIMEVE NE MIRMBAJTJE RRUGE	<u>497.493</u>	<u>3.997.493</u>

XI. SHPENZIME DHE INVESTIME PER SHERBIME PUBLIKE

Në zërin e shërbimeve publike janë planifikuar aktivitetet si gjelbërimi, mirmbajtje varreza, mirmbajtje godina dhe pastrimi . Aktiviteti i pastrimit të qytetit , fshatrave dhe institucioneve (shkollat, njësiti administrative, bashkisë) është planifikuar për tu kryer me sipërmarje private dhe kjo është parashikuar në shumën 28.252.000 lekë. Në këtë aktivitet janë parashikuar karburanti dhe pjesët e makinës që do të harxhojë kamioni dhe ruspa që do të menaxhojë institucioni tonë. Për rruspën është parashikuar për të punuar rreth 83 orë pune në muaj, ndërsa për kamionin 10 ton është parashikuar rreth 500 litra në muaj. Gjithashtu është parashikuar dhe blerja e një makine me kosh e cila do të përdoret për ndricimin rrugor, krastitjen e pemëve, apo zbukurime për qytetin me rastin e festave. Në shërbimin e varrezave planifikohet një sasi granil, cemento, hekur për prerjen e 60 kopmlete pllakash. Në shërbimin mirmbajtje godina janë parashikuar mirmbajtje të godinave si qendra shëndetsore, murre te jashtme etj. Dhe ne aktivitetin e gjelberimit janë parashikuar materiale për mirmbajtjen dhe shtimin e hapësirave të gjelberta. Tabela e mëposhtme pasqyron cdo artikull të këtij zëri.

ANALIZA	MALLRA DHE SHËRBIME	Detyrime 2015	Plan 2016
6022002	Ujë	0	240.000
	Aktiviteti i pastrimit		31.316.000
6021099	Vegla pune	70.000	70.000
6022009	Pastrimi	0	28.252.000
6023100	Karburant	0	1.994.000
6023200	Pjesë këmbimi	0	1.000.000
	Shërbimi i Varrezave		300.000
6021099	Materiale ndërtimi	0	300.000
	Mirmbajtje Godinash	73.600	1.216.000
6021099	Shërbime mirmbajtje	0	966.000
6021099	Vegla pune	73.600	250.000
	Aktivitetit i gjelbërimit	0	2.637.625
6021099	Fara lulesh dhe pleh	0	32.000
6021099	Makinë korse	0	36.000

6021099	Markuc	0	10.000
6021099	Gërshërë elektrike	0	6.000
6021099	Fidane (40 rrënjë)	0	120.000
6027500	Vendime gjyqësore	0	2.433.625
	SHUMA E SHPENZIMEVE NE SHERBIME PUBLIKE	<u>73.600</u>	<u>35.709.625</u>
2315140	Blerje kamiocina për shërbimet	0	1.000.000
2315140	Blerje makinë me kosh	0	1.500.000
2310400	Zgjerim i varrezave fshati Macurisht	0	450.000
	SHUMA TOTALE E INVESTIMEVE NE SHERBIME PUBLIKE	<u>0</u>	<u>2.950.000</u>

Meqënëse shërbimi pyjor kaloi si funksion në varrësinë e Bashkisë një pjesë e strukturës parashikohet nga transfertat të kushtëzuara dhe një pjesë nga fondet e bashkisë. Për mbarëvajtjen e punës ne kemi parashikuar një fond për blerjen e një makine dhe një fond për karburant për të cilat do të përdoren për të dy makinat e shërbimeve që do të blihen.

XII. SHPENZIME DHE INVESTIME PER SHEBIMIN PYJOR

ANALIZA	MALLRA DHE SHËRBIME	Detyrime 2015	Plan 2016
6023100	Karburant për vitin 2016	0	985.000
	SHUMA E SHPENZIMEVE NE SHERBIMIN PYJOR	<u>0</u>	<u>985.000</u>
2315140	Blerje kamiocina për pyjet	0	1.000.000
	SHUMA TOTALE E INVESTIMEVE NE SHERB.PYJOR	<u>0</u>	<u>1.000.000</u>

XIII. SHERBIME DHE TRANSFERTA TE TJERA

ANALIZA	MALLRA DHE SHËRBIME	Detyrime 2015	Plan 2016
6040002	Transfeta tek këshilli i qarkut 3.5%	0	2.730.000

602	Fondi i Emergjencave Civile (1%)	0	780.000
602	Fondi rezerve (3%)	0	2.340.000
6040009	Degës së Tatimeve (1%)	15.000	80.000
602	Agjent Tatimor Ujësjiellës sha	41.000	200.000
6061005	Kompesime në bursë për fëmijët jetim	0	336.000
6061003	Fondi për ndihmë ekonomike me kritere specifike	0	807.000
	SHUMA E SHPENZIMEVE NE SHEBIME TE TJERA	56.000	7.273.000

SHERBIME NGA TRANSFERTA SPECIFIKE

ANALIZA	MALLRA DHE SHËRBIME	Programi	Plan 2016
6009999	Paga dhe sigurime shoqerore ne A.Baze	9120	47.279.000
6009999	Paga dhe sigurime shoqerore ne A.Mesem	9230	1.857.000
6009999	Paga dhe sigurime shoqerore per administrimin e pyjeve	4260	1.630.254
6029999	Shpenzime operative per administrimin e pyjeve	4260	209.301
6009999	Paga dhe sigurime shoqerore per administrimin kanaleve kulluese	4240	1.848.315
6029999	Shpenzime operative per administrimin e kanaleve kulluese	4240	1.581.967
6009999	Paga dhe sigurime shoqerore per PMNZSH	10910	3.050.250
6029999	Shpenzime operative per PMNZSH	10910	384.800
6999999	Shpenzime operative dhe investime per rruget rurale	4520	9.980.779
	SHUMA E SHPENZIMEVE NE SHEBIME TE TJERA		67.821.666

Të nderuar zotërinj këshilltarë ju ftojmë të votoni buxhetin për vitin 2016, buxhet i cili do të jetë në shërbim të Komunitetit dhe Qytetarisë.

Përgjegjës i sektorit të Financës

Kryetari i Bashkisë